



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:066939  
Datë: 25.11.2021  
Numri i dokumentit: 02440257

**A.nr.1022/20**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Administrative,** me gjyqtaren Vjollca Limani, zyrtaren ligjore/procesmbajtësen Gzona Rama Demaj, në konfliktin administrativ të paditësit, S. S., nga Drenasi, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av.E. O. nga Prishtina, Rr.”...”, ..., C..., H..., nr...., kundër të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike -Policia e Kosovës dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me bazë juridike anulim i aktit administrativ, jashtë seancës, me datën 17 nëntor 2021 merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit, S. S., nga Drenasi, **si e bazuar.**

**ANULOHET** akti administrativ (njoftimi) me i të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPM SHCK), me numër reference A.nr.46/2020 ose numër protokollit 838/2020 i datës 12.05.2020 dhe detyrohet e paditura që në afat prej tridhjetë (30) ditësh me vendim të vendosë lidhur me ankesën e paditësit të datës A.nr.46/2020 e dt.21.02.2020 dhe të njëjtin t’ia dorëzojë palëve sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

**A r s y e t i m**

Paditësi, S. S., ka ushtruar padi në këtë gjykatë më datën 11.06.2020, kundër të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike -Policia e Kosovës, me bazë juridike, nxjerrjen e aktit administrativ sipas nenit 26 paragrafi 2.2 i Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative si dhe anulimin e njoftimit të KPM SHCK A.nr.46/2020 i dt.12.05.2020.

Gjykata shqyrtoi aktin administrativ të goditur me padi në përputhje me nenin 35 Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili përcakton se:

*“Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë në bazë të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji, kurse konstaton se akti administrativ i kontestuar përmban të meta esenciale, që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, e anulon me aktgjykim, aktin administrativ edhe pa e dërguar padinë në përgjigjen”.*

Po ashtu edhe në bazë të nenit 44.2 të njëjtit ligj i cili përcakton se:

*“Për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare”.*

Nga akti administrativ i kundërshtuar, gjykata vëren se e paditura për shkak të rrethanave të cilat kanë pamundësuar nxjerrjen e vendimit siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke iu përgjigjur ankesës së paditësit, ka lëshuar njoftimin **A.nr.46/2020 të datës 12.05.2020**. Paditësi i pakënaqur me këtë akt administrativ ka parashtruar padi në këtë gjykatë, duke kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata shqyrtoi kërkesëpadinë e paditësit dhe vlerësoi se në raport me këtë akt administrativ konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendimi i këshillit paraqet vendim administrativ të formës së prerë dhe i njëjti është i ekzekutueshëm.

Duke marr parasysh faktin se tani kanë pushuar shkaqet të cilat kanë pamundësuar të paditurën për vendosjen e çështjes dhe duke marr parasysh se çështja e vendosjes nga ana e të paditurës përbën çështje paraprake për vendosje në mënyrë meritore sipas padisë së paditësit, gjykata vendosi që çështjen ta kthejë tek e paditura për vendosje sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Të metat e cekura më lartë, janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të kundërshtuar, ndërsa rrethanat e reja tek e paditura mundësojnë zhvillimin e rregullt të procedurës administrative, në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që në afat prej 30 ditësh, në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr aktvendim të drejtë, e të bazuar në ligj, me të cilin do të njoftohen palët me kohë.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lart, gjykata në kuptim të neneve 5, 35, lidhur me nenin 44.2, dhe 46 par. 3 i Ligjit për konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Çështje Administrative**  
**A.nr.1022/20, datë 17 nëntor 2021**

**Zyrtarja Ligjore**  
Gzona Rama Demaj

**G j y q t a r j a**  
Vjollca Limani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.